



Frida Krifca  
emërohet ministre  
e Bujqësisë dhe  
Zhvillimit Rural

Faqe 2



Bujqësia kërkon  
4-fishimin e fondeve  
për subvencionin e  
fermerëve në 2022

Faqe 4



Rritet çmimi i bukës  
me 10 lekë nga disa  
operatorë për shkak të  
shtrenjtimit të miellit;  
Paralajmërohet në të  
gjithë tregun

Faqe 4



# AGROBIZNESI

**FED**  
invest

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,  
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.  
Tel: +355 4 2 251 910 /911  
Email: info@fedinvest.al  
kontakt@fedinvest.al  
www.fedinvest.al

## BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445  
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

E Premte, 17 Shtator 2021

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 421  
Çmimi 125 lekë

E përdryjavshme e pavarur

# SITUATA E ÇMIMEVE TË USHQIMEVE NË TREGJET E VENDIT RRITJA E ÇMIMEVE TË USHQIMEVE, KREU I AGROBIZNESIT: PANDEMIA, TËRMETI DHE ULJA E RIMBURSIMIT TË TVSH-SË PËR FERMERËT KANË NDIKUAR NË RRITJEN E KOSTOS SË PRODUKTEVE

Kreu i Agrobiznesit Shqiptar, Agim Rrapaj, në një intervistë për Report Tv, thotë se tre janë faktorët që kanë ndikuar në rritjen e kostos së produkteve. Rrapaj tha se në fushën e rritjes së ushqimit kanë ndikuar pandemia, tërmeti si dhe kushtet e motit, që nuk varen prej tyre dhe nuk ka abuzim nga tregtarët pasi diskutohet nga tregu ndërkombëtar

## RISI ALBANIA

200 kompani shqiptare  
marrin certifikatën për  
prodhime organike



Një projekt i Agjencisë Zvicerane  
për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra  
Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC

Faqe 2

**TASE GROUP**

Adresa: Rruga e Kavajës, Qendra "Kondor", Tiranë;  
Cel.: 0672035581; 0684855580

PIESE MOTORIKE  
FREKSIONE  
PERMISTOPA  
KUSHINETA  
KRIPA  
AKSE  
PIESE ELEKTRIKE  
PIESE HIDRAULIKE  
VAJRA DHE FILTRA

**Koyo.** **bepco** **FAG**

Kreu i Agrobiznesit: Pandemia, tërmeti dhe ulja e rimbursimit të TVSH-së për fermerët kanë ndikuar



REPORT TV

## FAO

FAO në prag të Samitit të Sistemeve Ushqimore të OKB,  
së bashku për transformimin e Sistemeve Agro-Ushqimore

Op-Ed nga Drejtori i Përgjithshëm i FAO-s

Faqe 10

## KËNDI I EKSPERTIT

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË,  
SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

Faqe 11, 12

## OPINION

Letër e Hapur Kryeministrit  
të Shqipërisë, Zotit Edi Rama  
Nga Shkëlqim Agolli, Ekonomist Agrar

TRE GABIMET QË RRËNUAN  
BUJQËSINË SHQIPTARE



Faqe 7

## ZHVILLIM RURAL

Agroturizmi "Te fuçitë", një  
kombinim i bukur i peizazhit  
natyror dhe produkteve bio



Faqe 13



## RISI ALBANIA

## 200 kompani shqiptare marrin certifikatën për prodhime organike

Tregu i prodhimeve organike kudo në botë po rritet me shpejtësi, duke sjelle një perspektive të mbarë për bizneset që kanë në fokus këto prodhime.

Albinspekt një njësi e financuar nga qeveria Zvicerane për krijimin dhe zhvillimin e infrastrukturës së bujqësisë organike në Shqipëri ka certifikuar deri më tani 200 biznese organike në të gjithë vendi të përfaqësuar nga ferma bujqësore.

Fermat organike shqiptare që zotërojnë këtë certifikatë u mundësohet eksporti në vendet të tjera. Po në mënyrë që këto produkte të eksportohen edhe në BE si organike, ato duhet të përdorin metoda të prodhimit organik të përcaktuara në legjislacionin e BE, proces që auditohet nga një certifikues i akredituar nga BE. Produktet duhet të kenë logon organike të BE-së dhe

si logon e standardit.

Autoritetet e BE-së mund të kërkojnë kontroll të shtuar të produkteve organike të importuara nga vendet jo-anëtare, përfshirë vendet e Ballkanit Perëndimor. Eksportimi i produkteve të frutave dhe perimeve organike të përpunuara në BE është i mundur vetëm me një certifikatë elektronike. Një sistem i ri i certifikatave elektronike për importet e produkteve organike është bërë i zbatueshëm që 19 prill 2017. Ai zëvendëson certifikatën e inspektimit që ka qenë në fuqi që nga viti 2008.

Tregu organik në Evropë po rritet me shpejtësi, me ritme dyshifrore nga viti në vit. Tregu më i madh Europe është



Gjermania me gati 10 miliardë euro në vit. Por konsumin për frymë e ka më të lartë Zvicra, e ndjekur nga Danimarka dhe Suedia. Fakti që numri i për-

punuesve dhe importuesve po rritet shumë më shpejt se sa numri i prodhuesve tregon se prodhimi organik nuk është në hap me kërkesën. Gjatë

vitit të pandemisë tregu i këtyre prodhimeve pësoi ulje në BE për shkak të kufizimeve dhe importeve nga vendet e largëta.

Në vitin 2020, BE importoi 2.79 milion ton produkte agroushqimore organike, një rënie prej 1.9% në krahasim me 2.85 milion ton të importuar në vitin 2019. Partnerët kryesorë tregtarë në lidhje me importet e produkteve organike në BE janë Ekuadori (12%), Republika Domenikane (9%), Kina (8%) dhe Ukraina (8%).

Kompanitë shqiptare të prodhimeve organike që përfaqësohen me larmishmëri produktesh që nga mjalti, perimet, frutat, mishi dhe

bulmeti, janë para një perspektive të mirë për të rritur fitimet në të ardhmen. Informacionet nga tregjet europiane tregojnë se prodhimet organike shiten me një çmim më të lartë se prodhimet e tjera ku përdoren kimikatet industriale.

Zhvillimi i prodhimeve organike u shkon për shtat fermave të vogla shqiptare të cilat janë të organizuara në sipërfaqe të vogla dhe vuajnë copëzimin e lartë të tokës. Duke prodhuar produkte me vlerë të shtuar ato të rrisin fitimet të cilat në Shqipëri favorizohen edhe nga sezoni dhe klima tipike mesdhetare.

Vitet e fundit eksportet e prodhimeve bujqësore janë rritur, teksa gjithnjë e më shumë fermerë po priren për të rritur diversitetin e prodhimeve, cilësinë e tyre dhe nuhatjen për gjetjen e tregjeve të reja të eksportit.

## KASH dhe RisiAlbania - Në një partneritet strategjik për të rritur eksportet dhe krijimin e vendeve të punës në agrobiznes për të rinjtë shqiptarë

• Gjatë vitit 2018 dhe 2019, RisiAlbania mbështeti eksportuesit dhe SHBB për të pilotuar certifikimin në grup GlobalG.A.P, duke përkrahur gjithashtu "Albinspekt", një organ certifikimi, për të ndërtuar një platformë për informues mbi standartin GlobalG.A.P – www.agroquality.al

• Paralelisht, Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar, MBZHR në partneritet me RisiAlbania mbështetën organizimin e GlobalG.A.P STOP TOUR në Shqipëri në mars 2019. Për herë të parë, organizata GlobalG.A.P dërgoi përfaqësues në Tiranë, për të rritur ndërgjegjësimin e aktorëve kryesorë mbi standardet që duhet të plotësojë çdo subjekt. Rreth 114 agrobiznese morën pjesë në konferencë.

• Pas kësaj ngjarje, eksportuesit shqiptarë filluan të rrisin interesin me tepër për certifikimin e GlobalG.A.P dhe sipërfaqja e produkteve të certifikuara GlobalG.A.P u rrit me rreth 300%.

• Në qershor 2019, ministri i Bujqësisë, Bledi Çuçi vizitoi disa eksportues ndër të cilët dhe "Doni Fruits", një nga eksportuesit që mori certifikimin në grup me GlobalG.A.P dhe mesazhi kryesor ishte

"Nëse produktet shqiptare janë GlobalG.A.P, siguria dhe cilësia e ushqimit e certifikuar janë 100% të garantuara dhe produktet mund të shiten në të gjithë Evropën". Ai ftoi eksportuesit e tjerë që të aplikojnë dhe të marrin certifikatën së bashku me fermerët.

-Kreu i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar, Agim Rrapaj, nëpërmjet KASH-it, ka punuar fort për informimin dhe sensibilizimin e fermerëve dhe krijimin e SHBB me bazë certifikimin me GlobalG.A.P të prodhimeve nga fermtat e tyre. Ai ka nxitur fermerët të jenë pjesë aktive në tajnime dhe të asistohen nga ekspertët për certifikimin e prodhimeve të tyre.

• Nëpërmjet shkëmbimeve të vazhdueshme ndërmjet RisiAlbania, KASH dhe MBZHR, në qershor të vitit 2020, MBZHR përfshiu GlobalG.A.P si pjesë e mbështetjes në Skemat Kombëtare, që do të thotë se eksportuesit dhe fermerët mund të kërkojnë ndihmë financiare për të marrë certifikimin.

• Rezultatet shumë pozitive të eksportuesve që pilotuan certifikimin në grup me GlobalG.A.P shtynë MBZHR për të përfshirë mbështetjen për GlobalG.A.P në skemat kombëtare.

## Një partneritet i vazhdueshëm midis RisiAlbania, KASH dhe MBZHR

• Në Qershor-Korrik, Shtator 2020, MARD dhe RisiAlbania do të mbështesnin GlobalG.A.P dhe "Albinspekt" në organizimin e GlobalG.A.P "Farm Assurance" (Program Trajnimi për konsulencën GlobalG.A.P) në Shqipëri, ku 15 këshilltarë dhe stafi i eksportuesve do të marrin pjesë në një trajnim mbi GlobalG.A.P për certifikimin individual dhe në grup.

• Së shpejti do të krijohet Grupi Kombëtar Teknik i Punës, si një organ kontakti për GlobalG.A.P, gjë e cila do të japë një impakt pozitiv në zhvillimin e standartit dhe sigurisë ushqimore.

• Ndërkohe të gjitha këto iniciativa nga njëra anë bëjnë të mundur që eksportuesit Shqiptarë të eksportojnë më shumë produkte në tregjet me vlera të larta dhe vendosin kontrata më të mira, nga ana tjetër fermerët do të krijojnë kontrata më të besueshme me eksportuesit, do të rrisin të ardhurat dhe sipërfaqet e tyre të frutave dhe perimeve të kultivuara dhe do të krijojnë punë për gra dhe burra si dhe të rinj në të gjitha nivelet e zinxhirit të vlerës

## Themelimi i grupit teknik të punës për standardin GlobalG.A.P tashmë është një realitet

Themelimi i grupit teknik të punës për standardin GlobalG.A.P tashmë është një realitet dhe gati për të startuar nga puna për realizimin e qëllimeve të përbashkëta në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të këtij standardi në Shqipëri. Sipas një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës, Albinspekt bio.inspecta - anëtare e GlobalG.A.P ka themeluar grupin teknik të punës rreth standartit GlobalG.A.P, me përfaqësues nga grupe të ndryshme interesi. Falenderojmë partnerët: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar, AgroWeb, Doni Fruits Albania, ADAD Mallore, EQSC - European Quality and Safety Control, Agrotechnica shpk për kontributin dhe gatishmërinë e treguar. Ky program u realizua me mbështetjen e RISIAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC.

## Frida Krifca emërohet ministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural



Frida Krifca, drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR), është emëruar nga kryeministri Edi Rama si pjesë e kabinetit 3.

Kreu i qeverisë e ka vendosur Krifcën në krye të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, duke zëvendësuar kështu ministrin Milva Ekonomi.

## IIPARD III, 146 milionë euro për fermerët

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca tha se "arritja e 1 miliard lekë eksporteve bujqësore është shifër ambicioze dhe është pjesë e vizionit të Shqipërisë rurale 2030".

Në fjalën e mbajtur në Kuvend Krifca theksoi: "Premisa është shumë pozitive. Ne kemi gjetur në vitin 2013 eksportet në vlerën 150 milionë USD dhe aktualisht ato janë në vlerën e 400 milionë euro".

Sipas saj, në fokus të punës së qeverisë do të jenë prodhimet primare dhe mbështetja e drejtpërdrejtë e fermerëve me një fond prej 50 milionë euro si dhe me heqjen e taksave për naftën, që është një skemë që do të vazhdojë vit pas viti.

"Në programin IPARD III, për të cilin do të marrim akredimin shumë shpejt, brenda vitit 2022, ky program filon, kemi rritur vlerën e financimit në 146 milionë euro, duke e çuar në një stad të ri nivelin e investimeve në bujqësi, sepse kemi mësuar fermerët shqiptarë sesi të aksesojnë fondet e BE-së".

Lidhur me mbështetjen për peshkimin Krifca vuri në dukje se, mbështetja për sektorin e peshkimit do të vijë nëpërmjet një sistemi fiskal, ku TVSH-ja zerohet për 27 zëra doganore të peshkimit, nga rrjetat e peshkimit, motorët etj.

"Synimi është rritja e kuotave të eksporteve drejt BE-së për aqun e përpunuar. Industria përpunuese e peshkimit është pjesë e programit IPARD III me 146 milionë euro, gjë që nuk ka qenë më parë. Ndërkohë që synojmë forcimin e infrastrukturës portuale përmes investimeve në merkato e peshkut, akuakulturë dhe nxitjen e kultivimit të troftës që është mjaft e kërkuar nga tregjet e huaja", tha Krifca.





## INTERVISTA

## SITUATA E ÇMIMEVE TË USHQIMEVE NË TREGJET E VENDIT

# RRITJA E ÇMIMEVE TË USHQIMEVE, KREU I AGROBIZNESIT: PANDEMIA, TËRMETI DHE ULJA E RIMBURSIMIT TË TVSH-SË PËR FERMERËT KANË NDIKUAR NË RRITJEN E KOSTOS SË PRODUKTEVE

*Kreu i Agrobiznesit Shqiptar, Agim Rrapaj, në një intervistë për Report Tv, thotë se tre janë faktorët që kanë ndikuar në rritjen e kostos së produkteve. Rrapaj tha se në fushën e rritjes së ushqimit kanë ndikuar pandemia, tërmeti si dhe kushtet e motit, që nuk varen prej tyre dhe nuk ka abuzim nga tregtarët pasi diskutohet nga tregu ndërkombëtar*

Qytetarët shqiptarë po shpenzojnë më shumë se vitin e kaluar për të blerë produktet e shportës. Sipas INSTAT, çmimet e produkteve ushqimore dhe pijeve joalkoolike janë rritur me 4.6%, krahasuar me gushtin e vitit të kaluar dhe rritja e çmimeve është më e lartë tek zarzavatet dhe patatet me 18.3%.

Kreu i Agrobiznesit, Agim Rrapaj në një intervistë për Report Tv, thotë se tre janë faktorët që kanë ndikuar në rritjen e kostos së produkteve. Rrapaj tha se në fushën e rritjes së ushqimit kanë ndikuar pandemia, tërmeti si dhe kushtet e motit, të cilët janë faktor objektiv dhe nuk varen nga fermeri.

Po ashtu Rrapaj tha se ka pasur edhe një problem fiskal që është ulja e rimbursimit të TVSH-së me 6% për produktet ushqimore që prodhojnë fermerët për tregun e vendit dhe pagesa nga qendrat e



një rritje kudo, pasi ne duhet të ishim të përgatitur për këtë situatë. Me fushën e ushqimit veprojnë disa hapa, pandemia,

një problem tjetër fiskal, ulja e rimbursimit të TVSH-së 6% për produktet ushqimore që prodhojnë fermerët tanë për tregun e vendit dhe pagesa nga qendrat e grumbullimit me 20% ku 14% do t'i faturon

torin e kaluar, se do të ketë një rritje të çmimit të grurit nga Rusia, ndërkohë që shtoi se do të ketë edhe një rritje të çmimit të makaronave.

"Ishte një situatë e pritur prej kohësh. MEPJ na ka njof-

qenë me rezerva dhe tani që rezervat mbaruan pritej rritja e çmimit të bukës. Rritja e çmimit të grurit në tregun ndërkombëtar dhe jo vetëm i grurit për bukë, por edhe ai për makarona. Pritet edhe rritja e makaronave, pasi rritja e grurit të fortë që shërben për makaronat është rritur dy herë më shumë sesa gruri për

bukën" - tha Rrapaj.

Rrapaj theksoi se rreth 83% e fermerëve janë të paformalizuar dhe këta kanë vështirësi të mëdha për të negociuar për çmimin. Sipas tij informaliteti është një çështje që duhet të hyjë në rrugën e zgjidhjes një minutë dhe më parë, në të kundërt me këto fenomene do të ndeshemi sërish.

"Ne kemi rreth 83% të fermerëve të paformalizuar, që janë në fushën e bujqësisë dhe këta kanë vështirësi të mëdha për të negociuar për çmimin. Së dyti ka të bëjë me kostot e prodhimit, tërmeti, pandemia dhe ulja e rimbursimit të TVSH-së kanë ndikuar tek çmimi i prodhuesit. Prodhuesi ynë është në disavantazh në krahasim me grumbulluesin, pasi nuk kanë kontratë, nuk njohin tregun dhe mbjellin me parashikimet që kanë pasur më para. Prodhuesi nuk ndikon dot tek grumbulluesi. Ne kemi folur në mënyrë të tillë që informaliteti është një çështje që duhet të hyjë në rrugën e zgjidhjes një minutë dhe më parë, në të kundërt me këto fenomene do të ndeshemi sërish" - tha Rrapaj.

**Agim Rrapaj:**

**Nuk ka asnjë abuzim me çmimet, është rezultat i konjunkturës ndërkombëtare. Ka një rritje kudo, pasi ne duhet të ishim të përgatitur për këtë situatë**

grumbullimit me 20%, ku 14% do t'i faturon konsumatorit. Sipas tij nuk ka pasur abuzim nga tregtarët, pasi çmimi është diktuar nga tregu ndërkombëtar.

"Nuk ka asnjë abuzim me çmimet, është rezultat i konjunkturës ndërkombëtare. Ka

tërmeti, kushtet e vështira të motit janë faktorë objektivë që nuk varen prej nesh, por kanë ndikuar në rritjen e kostos së produktit. Kjo është një kosto që ne e kemi pritur. Janë mbajtur kostot me rezerva, por ka një kufi dhe nuk mund të shkojë me tej. Ka pasur dhe

“

**Agim Rrapaj:**

**Ka pasur dhe një problem tjetër fiskal, ulja e rimbursimit të TVSH-së 6% për produktet ushqimore që prodhojnë fermerët tanë për tregun e vendit dhe pagesa nga qendrat e grumbullimit me 20% ku 14% do t'i faturon konsumatorit**

konsumatorit"- theksoi Rrapaj.

Kreu i Agrobiznesit pohoi se ato ishin lajmëruar që nën-

tuar që prej nëntorit se do të ketë një rritje të çmimit të grurit nga Rusia. Deri tani kanë

“

**Agim Rrapaj:**

**Ne kemi rreth 83% të fermerëve të paformalizuar, që janë në fushën e bujqësisë dhe këta kanë vështirësi të mëdha për të negociuar për çmimin. Së dyti ka të bëjë me kostot e prodhimit, tërmeti, pandemia dhe ulja e rimbursimit të TVSH-së**





## INFORMACIONE

# Bujqësia kërkon 4-fishimin e fondeve për subvencionin e fermerëve më 2022

Ministria e Bujqësisë ka dorëzuar një kërkesë në Ministrinë e Financave me qëllim që në buxhetin e vitit 2022 t'i shtohen edhe 3 miliardë lekë (24 mln euro) për skemën kombëtare, që ka në themel kompensimin e fermerëve.

Ministria e Bujqësisë kërkon që me këtë shtesë të çojë fondet për skemën kombëtare në një total prej 4 miliardë lekësh ose 32 milionë eurosh, duke tentuar për të 4-fishuar fonde në këtë zë.

Kërkesa për subvencione po rritet vit pas viti, për shkak të organizimit dhe formalizimit më të lartë të fermerëve.

Tani gjithnjë e më shumë fermerë i plotësojnë kushtet për subvencion, por qeveria ofron fonde të pakta në krahasim me vendet e tjera të rajonit dhe Europës.

Në vitin 2019, Kosova e mbështeti bujqësinë me 53 milionë euro nga buxheti i shtetit, Mali Zi me 61 milionë euro, ndërsa Shqipëria me vetëm 6 milionë euro. Me këtë mbështetje fermerët shqiptarë jo vetëm nuk prodhojnë me çmime konkurruese por

shpesh përballen me humbje të mëdha për shkak të kostove të larta që nuk kompensohen nga subvencionet.

Udhëzimi për shpërndarjen e subvencionit këtë vit mbështet (kafshët riprodhuese) për fermat me jo më pak se 70 krerë dele dhe/ose dhi në vlerën 1.200 lekë për krerë, jo më shumë se 360.000 lekë për subjekt. Mbështetje në vlerën 10.000 lekë për krerë për fermat jo më pak se 5 krerë lopë, jo më shumë se 500.000 lekë për subjekt.

Mbështetja për mbarëshkrimin e bletarisë me 1.000 lekë për koshere për fermat me jo më pak se 50 zgjoje, me financime për jo më shumë se 150.000 lekë për subjekt.

Mbështetja parashikon financim për zëvendësimin e plastmasit termik për serrat diellore ekzistuese për prodhimin e perimeve në vlerën 300.000 lekë për ha, rrushit për tavolinë në vlerën 100.000 lekë për ha dhe tunelet plastike për prodhimin e luleshtrydhes, në vlerën 500.000 lekë për subjekt. Sipërfaqja e serrës ose tunelit plastik për prodhimin e

luleshtrydhes të jetë jo më pak se 0.2 ha.

Për shtimin e sipërfaqeve të mbjella me bimë mjekësore dhe aromatike mbështetja jepet në vlerën 200.000 lekë për ha, por jo më shumë se 1.000.000 lekë për fermerët individualë dhe për grup fermerësh. Ndërsa për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor vlera e përfitimit financiar është jo më shumë se 4.000.000 lekë.

Mbështetja për linja/makinë/pajisje për përpunimin, paketimin, standardizimin dhe etiketimin e ullirit, vajit të ullirit, bimëve mjekësore e aromatike dhe qumështit në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5.000.000 lekë për subjekt. Përfitues janë subjektet, të cilat nuk mund të mbështeten nga programi IPARD III.

Mbështetja për investime në argoturizëm kundrejt planit të biznesit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 10.000.000 lekë për subjekt. Përfitues janë subjektet, të cilat nuk mund të mbështeten nga programi IPARD.



## Rritet çmimi i bukës me 10 lekë nga disa operatorë për shkak të shtrenjtimit të miellit; Paralajmërohet në të gjithë tregun

Prej 2 javësh disa furra në vend kanë rritur çmimin e bukës me 10 lekë, duke e çuar në 80 lekë, me një shtrenjtim rreth 14%.

Anëtarë të Shoqatës të Prodhuesve të Bukës, Patiçerive dhe Brumrave thonë se së shpejti rritja e çmimit të bukës me 10 lekë do të ndodhë në të gjithë tregun. Arsyeja kryesore e rritjes të çmimit të bukës është rritja e çmimit të miellit në tregun vendas me 5 lekë/kg që në fillim të muajit gusht.

Anëtarë të Shoqatës të Prodhuesve të Bukës pohuan për Monitor se shqetësuese për ta është edhe shtrenjtimi i çmimit të përbërësve të tjerë, ndërsa në terësi sektori po vuan edhe mungesën e punonjësve për shkak të emigrimit. Kompanitë e blojës në vend shpjeguan se prej 1 viti ata po blejnë grurë me çmim 60%

më të lartë se vjet dhe kjo i ka detyruar ata të rrisin 10% çmimin nga fillimi i muajit gusht. Operatorët paralajmërojnë se rritja e miellit do të shkojë deri 20%, për shkak të krizës të prodhimit të grurit në botë. Rritje të lartë këtë vit parashikohet të ketë edhe për çmimin e makaronave si ato të importit dhe të prodhuar në vend, për shkak të shtrenjtimit të fortë të miellit të grurit për prodhimin e tyre.

**Disa furra rriten çmimin me 10 lekë; Paralajmërohet rritje në të gjithë tregun, nëse shtrenjtimi i miellit nuk ndalet**

Anëtarë të Shoqatës të Prodhuesve të Bukës, Patiçerisë dhe Brumrave thanë për Monitor se rritja e çmimit me 10 lekë prej 2 javësh ka qenë individuale. Nëse rritja e çmimit të miellit do të vazhdojë, shtrenjtimi i bukës në të gjithë tregun

është i pashmangshëm. "Nga disa operatorë në treg ka pasur rritje të çmimit të bukës me 10 lekë, për shkak të shtrenjtimit



të çmimit të miellit me 5 lekë/kg, rritjes të çmimit të vajit, margarinës. Rritja ka qenë in-

## Festa e Ardenicës, Braçe: Fshati historik po kthehet në destinacion turistik

Festa e Ardenicës edhe këtë vit mbledhi bashkë shumë njerëz nga bashkia e Lushnjës. Ardenica konsiderohet si një nga zonat më të rëndësishme të trashëgimisë historike e kultu-



rore, por edhe si një zonë me prodhimtari të lartë bujqësore.

Bashkia e Lushnjës rikthehu sot traditën e festës në Ardenicë, atë të panairit të prodhimeve bujqësore tradicionale, që pati si qëllim promovimin e vlerave të kësaj zone.

Në shoqërinë e këngëve dhe valleve të zonës, performuar nga grupi i fëmijëve të Qendrës Kulturore të Fëmijëve Lushnjë dhe në bollëkun e prodhimeve tradicionale si rrushi, rakia, vera, gatimet e zonës, sheshi pranë Manastirit të Ardenicës u kthye në një ditë feste.

Pjesë e kësaj atmosfere ishin edhe zv.kryeministri Erion Braçe, kryetarja e bashkisë, Eriselda Sefa dhe deputetët Lindita Buxheli dhe Bujar Çela.

"Festa e Ardenicës përkon në ditën e lindjes së Shën Marisë", tha Braçe, ndërsa uroi çdo shqiptar të besimit të krishterë katolik e ortodoks, Ditën e lindjes së Shën Marisë.

"Bashkia Lushnje rikthehu sot traditën e festës në Ardenicë, atë të panairit të produk-

teve bujqësore, blegtorale dhe ushqimet tradicionale të një zone që po kthehet gjithnjë e më shumë në destinacion turistik. Do jetë e përvitshme e gjithnjë e më e madhe, përf-

cionale të zonës".

"Datën 8 shtator do ta kthejmë në një festë lokale dhe do ta vendosim në kalendarin e guidave turistike, për ta kthyer këtë zonë në një destinacion turistik", tha Sela.

Manastiri i Ardenicës, apo Manastiri "Lindja e Hyjlindës Mari" është manastir i krishterë ortodoks, i vendosur në një kodër, përgjatë rrugës që lidh Fierin me Lushnjën.

Mendohet se themelet e këtij manastiri janë hedhur në vitin 1282 me nismën e perandorit Andronik II Paleolog të Bizantit, i cili e ngriti këtë tempull pas fitores mbi anzhuinët në Berat.

Fare pranë këtij tempulli, në rrethinat e të cilit sot ndodhet manastiri, kalonte dega jugore



shirëse për gjithë Myzeqenë në Ardenicë", u shpreh Braçe, teksa ndalesën e radhës, po në Ardenicë, e kishte me të gjithë prodhuesit e fidanëve frutorë, agrume e arrore.

Ndërsa kryetarja e bashkisë së Lushnjës, Eriselda Sefa u shpreh: "Qëllimi kryesor i kësaj feste është që të promovojmë bukuritë natyrore që ka kjo njësi, që nga Manastiri i Ardenicës, deri tek prodhimet e bollshme bujqësore dhe gatimet tradi-

e rrugës antike Egnatia, pikërisht 1 km në perëndim të tij.

Kisha e Shën Marisë, në brendësi të Manastirit, përmban afreske të mrekullueshme të vëllezërve Kostandin dhe Athanas Zoografi.

Manastiri është një monument kulture mjaft tërheqës për turistët e vizitorët, si për shkak të interesit kulturor që paraqet, ashtu edhe për pozicionin gjeografik dhe bukurinë natyrore mjaft të veçantë të vendit ku ndodhet.

amortizojnë koston e lartë, por gradualisht rritja për 10 lekë për bukë pritet të nisë në të gjithë tregun, nëse do të vijohet me rritje të çmimit të grurit", pohuan anëtarë të Shoqatës të Prodhuesve të Bukës.

**Shtrenjtimi i grurit 65% në bursa rrit çmimin e miellit në tregun vendas**

Administratori i kompanisë "Bloja" dhe "Prima", Adi Haxhiymeri pohoi për Monitor se prej gati një viti çmimi i grurit në tregjet e huaja është shtrenjtuar rreth 65%.

Arsyet sipas tij janë rënia e prodhimit të shteteve më të mëdha prodhuese, por edhe për shkak të thatësirës dhe përmbytjeve në disa vende të europës.

Z. Haxhiymeri nënvizon se këto faktorë kanë ndikuar te rritja e koston të prodhimit të miellit, duke ndikuar edhe të shtrenjtimi i shitjes të miellit me 5 lekë/kg përgjatë gjithë muajit gusht. "Po bëhet

gati viti që çmimi i grurit në tregjet e huaja është rritur 60-65%. Konkretisht vjet në muajin tetor çmimi i grurit ishte 220 dollarë/ton (i zhdoganuar) dhe sot që flasim po zhdoganohet me 360 dollarë/ton.

Çmimi i lartë ka ndikuar të koston e miellit. Në krahasim me rritjen e lartë të çmimit të grurit, mielli është rritur 10-12%. Pra nga 50 lekë/kg mielli është bërë 55 lekë/kg përgjatë muajit gusht. Rritja pritet të shkojë më tutje, pasi nuk arrin të mbulojë kjo diferencë, pavarësisht rezervave që kanë kompanitë. Rritja tjetër do të jetë e pashmangshme.

Arsyet e rritjes të çmimit të grurit në bursa kanë ardhur për shkak të rënies të prodhimit nga shtetet, si: SHBA, Kanada dhe Rusia, pa llogaritur demet që shkaktuan përmbytjet në Gjermani, Francë etj dhe thatësirat në pjesën tjetër të globit, nga shteti i

(Vijon në faqen 5)



## AGROTURIZËM

# Festa e Rroshnikut, panair me produkte “bio” nga 13 fshatra të Beratit, fermerët: Të rregullohet rruga, të çojmë prodhime në treg

I njohur për pemëtarinë e bukuritë e natyrës fshati Rroshnik i Beratit ka organizuar

prodhojmë shumë fiq, kemi fiqtë tanë që kanë ardhur që në kohën e Turqisë e deri më sot.

shprehet një tjetër.

Në panair nuk kanë munguar turistët vendas e të huaj, të cilët e cilësojnë festën një eksperiencë të paharrueshme.

“Ndihe mi shumë të emocionuar që jemi në Festivalin e Beratit dhe ndihemi me fat që ndodhemi këtu sot. Me të vërtetë po e shijojmë pasi njerëzit janë shumë të mirë këtu. Ne vijmë nga Gjermania për pushime dhe do të qëndrojmë për 8 ditë në Berat”, shprehet turistja.

“Është mrekullueshëm, njerëzit janë shumë të mirë. Beratit është një qytet i bukur dhe jemi shumë të lumtur që ndodhemi këtu. Ne vijmë nga Gjermania dhe do të qëndrojmë për disa ditë”, thotë turisti tjetër.

Me rreth 4 mijë banorë, fshati turistik i Rroshnikut një-



panairin e përvitshëm me prodhime “bio” të zonës, ku dominojnë arrat, verërat, rakia dhe fiqtë e Beratit. Në stenda të ndara fermerët kanë prezantuar prodhimet nga 13 fshatra ndërsa kërkojnë më shumë mbështetje nga shteti për nxjerrjen e produkteve në treg.

Në një atmosferë festive, me muzikë e recitime fëmijësh është organizuar edhe këtë vit panairi i prodhimeve “bio” të zonës në fshatin turistik, Rroshnik të Beratit.

I njohur për kultivimin e fijeve, arrave dhe bajameve, në panairin e Rroshnikut u ekspozuan produktet e 13 fshatrave të zonës. Fermerët kërkojnë ndihmën e shtetit për përmirësimin e infrastrukturës rrugore për nxjerrjen e produkteve në treg. “Ne si fshat i Rroshnikut,

Kemi dhe rrush, vaj ulliri, por fiqtë janë më kryesori që ne tregtojmë”, thotë një fermer.

“Kemi prodhime të zonës si



dardhën, pjeshkën që janë bio, por edhe rrushin dhe fikun. Po na vret rruga, nuk kemi rrugë”,

het për kultivimin e pemëtarisë me rreth 70 hektarë të mbjellë me fiq, rrush, arra e bajame.

## Aksion në thertore dhe tregje - Urdhri i Ministrisë së Bujqësisë, nga 15 tetori kontrollon në të gjithë vendin

Nga data 15 Tetor, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve do të nisë kontrollet intensive në të gjithë thertoret dhe tregjet në mbarë vendin, me qëllim garantimin e sigurisë së produkteve tek konsumatorët. Urdhri i cili ka hyrë në fuqi mban firmën e Ministres së Bujqësisë në detyrë, Milva Ekonomi. Sipas urdhrit në fjalë, Drejtoritë Rajonale të Veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve të koordinojnë aktivitetet e kalimit të

ushtimit të detyrave me strukturat e veterinarisë, me çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, të territorit ku ushtrojnë funksionet dhe kompetencat e tyre.

Pavarësisht aksioneve që janë ndërmarrë vite më parë në këtë sektor dhe reformës në veterinarin, sërish ka problematika të theksuara në procesin e lëvizjes, shitjes dhe therjes së kafshëve. Shumë bagëti lëvizin të paidentifikuara, pa matrikull, duke u kthyer në burim infek-

sioni. Certifikata veterinare vijon të mbetet një problem duke i bërë qytetarët të pasigurt për mishin që blejnë për konsum, pasi është kryesore në garancinë që jep për kontrollin e bagëtive që shkojnë për therje.

Ndërsa shumica e tregjeve të bagëtive nuk plotësojnë as kushtet minimale të sigurisë dhe higjenes. Po ashtu, abuzime ndodhin edhe në thertore, ku nuk mungojnë rastet që produkte e shitura të jenë të pacertifikuara.



## Krifca: Shifrat që tregojnë “zgjimin” e turizmit rural

“Turizmi rural është një koncept me të cilin si AZHBR filluam të punojmë me dedikim në vitin 2018”.

Kështu shprehet drejtoresha e AZHBR-së, Frida Krifca duke sjellë vizionin e punës së deritanishme dhe në vijim.



” Me vizion të qartë për diversifikimin e fermes dhe ofrimin e një alternative shërbimi turizmi rural ne fshat. Objektivi sigurisht ishte nxitja dhe përsheptimi ekonomik lokal me efekt zinxhir në të gjithë komunitetin. Objekte kulturi, shtigje, vepra historike e rrethoja, ulla qindra vjeçare, kala të gurta, jeta e ngadalte e fshatit, ngjyrat e bujkut e blegtorit në stan, prodhuesit të mjaltit, mishit e perimeve, artizanit, mjeshtrit që punon brumin, balten, leshin, drurin, gurin e metalin. Paraqesin interes për vizitorë për të zbuluar identitetin rural të vendit tonë. Natyra magjike nuk mjafton. Vizitorët shkonin në një mrekulli si Labova por nuk kishin ku flinin deri dje pasi nuk kish asnjë strukturë pritëse apo shtëpi fshati të hapur dhe ktheheshin ta kalonin natën në qytet, diku”, shprehet ajo.

” Kështu, për këtë vizion, bashkërisht me njëzë të nxitur të investonin në fshat edhe për shkak të një regjimi

fiskal favorizues, punuam për ndërtimin apo shndërrimin e rikonstruksionin e 71 bujtinave, shtëpive tradicionale apo investimeve të ndryshme në turizem rural në 33 bashki e 58 fshatra të ndryshëm të Shqipërisë duke shtuar kapacitetet për

1,331 shtreter dhe 588 dhoma”, tha Krifca.

“Injektuam financim e mundësuam investime në shërbime akomoduese dhe



rekreative nga stacione biçikletash, sisteme rrekesh, dyqane produktesh tipike e pista kuajsh nga Gruemirë në Malësi të Madhe, Lepurakë në Bulq-

izë, Lure në Diber, Mamurras në Kurbin, Kurdari në Burrel, Gjinar në Elbasan, Voskopojë e Boboshticë në Korçë, Rroshnik në Berat, Linë të Pogradecit, Bajkë në Delvinë, Muzinë në Sarandë, Prezë, Shën Gjergji e Petrelë në Tiranë, Radë e Gjepalaj në Durrës, Qilarisht, Grabovë e Leusë në Përmet, në Peshtan e Nivice në Tepelenë në Antigone në Gjirokastrë e plot të tjerë, cep e më cep të këtij vendi të magjishëm, të bekuar me njëzë shpirtplot e monumente historike e natyrore”, theksoi ajo.

Sipas Krifcës, fshati shqiptar ka filluar të shperfaqet në dimensionin e trashëgimisë kulturore, arkitekturore dhe “jeta e ngadalte” (slow life) që ndodh në keto komunitete, në qendra historike, mund të shijohet tashmë në kushte komode qëndrimi e shërbimi që do të vijojnë të përmirësohen e transformojnë ofertën turistike rurale.

“Mund të njihesh me njëzë në shesh të fshatit, merr pjese në punët e tyre, prodhon vete, kujdesesh dhe eksploron naty-

## Me mbështetjen e AZHBR-së, Berti shtoi fermën me 100 krerë të imta

Berti nga fshati Karbunarë i Fierit, është kthyer nga emigrimi 15 vite më parë dhe zgjodhi që prej asaj kohe, të krijonte tufën e vogël me 7-8 krerë dele.

Me dëshirën për t'u zhvilluar e shtoi tufën dhe sot ka rreth 100 krerë.

Drejtoresha e Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, Frida Krifca bën të ditur se, “Berti është mbështetur nga AZHBR nëpërmjet Skemës Kombëtare, për tufën bazë të matrikulluar”.

“Ndërsa, qumështin e tregton i sigurt në kompanitë e përpunimit të mbështetura po nga AZHBR. Një urë bashkëpunimi që funksionon zinxhir”, tha

Krifca.

Berti tregon se sheh njëzë që po i kthehen tokës dhe se fshati i tij Stan-Karbunarë,

që dikur kishte orientim emigrimin, ka ndryshim, dhe po qaset ndaj zhvillimit me njëzë që po investojnë në zonë.





# Marrëveshjet mes tregtarëve të miellit, Autoriteti i Konkurrencës së shpejti me vendim

Autoriteti i Konkurrencës (AK) njoftoi se do të shprehet së shpejti me një vendim nëse prodhuesit kryesorë të miellit në vend, po vazhdojnë të ndjekin një marrëveshje të ndaluar, me qëllim fiksimin e çmimeve.

Në një njoftim zyrtar, AK thekson se, “ka konstatuar sjelljen e bashkërenduar midis ndërmarrjeve të importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit, pasi këto ndërmarrje kanë bashkërenduar sjelljen, duke caktuar çmimet e shitjes dhe duke kontrolluar prodhimin në tregun e miellit për shkak të integritetit vertikal, sjellje e cila bie ndesh në kushtet e zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

AK thekson në vendimin e saj, detyrimin e ndërmarrjeve të mos caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes,

apo çdo kusht tjetër tregtimi, të mos kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet, të mos



ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit. Gjatë periudhës së monitorimit të raportojnë çdo 3 (tre) muaj pranë AK-së të dhëna mbi blerjet dhe shitjet në

përbushje të detyrimeve të dhëna sipas kësaj pike.

Moszbatimi i përbushjes së pikës III të këtij vendimi,

ndëshkohet me penaltitetet përkatëse, citon AK, ndërsa bën të ditur se do të monitorojë sjelljen e ndërmarrjeve për një periudhë 1-vjeçare.

## Brace: Karteli i importuesve të grurit njofton rritjen e çmimeve me 30 %

Deputeti i Partisë Socialiste, Erion Brace ngriti shqetësimin e rritjes së çmimit të miellit

nga importuesit.

Brace tha se teksa media merret me “dy kufoma” që

mbajnë peng debatin publik në këtë vend, sot karteli i importuesve të grurit, prodhimit të miellit e bukës ka njoftuar se do rrisë çmimet me 30 %.

“Sot dita e katërt, e gjithë media vijon merret me “dy kufoma” që luajnë luftash. Dy kufoma që mbajnë peng gjithë debatin publik në këtë vend. Ndërkohë iku, u harrua karteli i importuesve të grurit, prodhimit të miellit, shitjes, prodhuesve të bukës. Sot karteli ka njoftuar çdo prodhues brumërash se do të rrisë çmimet me 30 %. Mer-runë me dy kufoma që bëjnë sikur vrasin njëri-tjetrin më 14 shtator”, deklaroi Brace.



## Rritet çmimi i bukës me 10 lekë nga disa operatorë për shkak të shtrenjtimit të miellit; Paralajmërohet në të gjithë tregun

(Vijon nga faqja 4)

Australisë e më tej. Thatësitrat jo vetëm që ndikuan te rënia e prodhimit, por edhe te rendimentit, pasi temperaturat e larta e thanë shumë kokrrën e grurit. Një tjetër arsye është edhe rritja e konsumit të grurit nga Kina. Kina këtë vit ka rritur kërkesën për import 10-20 mln tonë më shumë se vjet, ndërkohë që vetë tregu ka pësuar rënie prodhimi me 20 mln tonë. Të gjitha këto arsye krijuan këtë krizë të madhe”.

Përfaqësuesi i kompanisë “Bloja” dhe “Primo” Adi Haxhiymeri thotë se për të amortizuar disi rritjen e çmimit të grurit në bursat e huaja, qeveria duhet të ndërhyjë me heqjen e TVSH-së të grurit dhe miellit. “Kjo

është një kërkesë e përsëritur nga kompanitë e blojës. Ende nga qeveria nuk marrë ndonjë masë konkrete. Heqja e TVSH-së 20% përkohësisht do të amortizonte disi rritjen e çmimit të miellit.”

**Makaronat këtë vit do të kenë shtrenjtimin më të lartë**

Çmimi më i lartë të produktet e brumërave këtë vit pritet të jetë te makaronat. Arsyeja është dyfishimi i çmimit të grurit të fortë për prodhimin e makaronave. “Është hera e parë në histori që çmimi i grurit të makaronave është rritur mbi 100%. Kjo rritje e lartë pritet shumë shpejt të reflektohet të çmimi i makaronave të importit dhe ato të prodhuara në vend. Ndikimi pritet të jetë i fortë në të gjithë botën. Kanadaja prodhoi 80% më pak

grurë të fortë (për makaronat), Franca 40% më pak dhe të gjitha zonat e tjera prodhuan më pak. Të gjitha kompanitë e prodhimit të makaronave në botë kanë paralajmëruar rritjen e tyre”, thekson z. Haxhiymeri.

Vjet në vendin pas hapjes të ekonomisë konsumi më i lartë ndër produktet e shportës ishte për makaronat. Në MUJIN E VERËS TË VITIT TË KALUAR KONSUMI I MAKARONAVE U RRIJT 79% MË SHUMË SE NË 2019 SIPAS DREJTORESHËS TË FINANCËS, ZNJ. JUNIS URUÇI NË KOMPANINË E TREGTIMIT TË PRODUKTEVE USHQIMORE, “Teuta”. Përfaqësuesja e kompanisë “Teuta” pohoi më herët se rritje të lartë të konsumit në verën e 2020 pati edhe për drithërat e shëndetshme me 74% më shumë se në 2019.

## Ethet Afrikane të Derrit - Fushata është shtrirë në shtete të reja

**EFSA (Autoriteti Evropian për Sigurinë Ushqimore) po rrit përpjekjet e saj për të ndaluar përhapjen e etheve afrikane të derrave në Evropë duke zgjeruar fushatën e saj në nëntë shtete të tjera.**

Verën e kaluar, EFSA nisi një fushatë të madhe për të rritur ndërgjegjësimin ndaj sëmundjes në Evropën Jug-Lindore. Fushata u krye në partneritet me autoritetet vendore në shtetet që përbëjnë “rajonin shqetësues” — Shqipëri, Bosnje Hercegovinë, Kroaci, Greqi, Kosovë, Mal i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi dhe Slloveni — për shkak të afërsisë së tyre me shtetet ku virusi është i pranishëm.

EFSA po e shtrin tashmë fushatën, fokusuar kryesisht tek fermerët, në Bullgari, Republikën Çeke, Lituanë, Letoni, Poloni, Sllovakia, Estoni, Hungari dhe Rumani.

Nikolaus Kriz, kryetari i Njësisë së Shëndetit të Kafshëve dhe Bimëve të EFSA, tha: “Si një organizatë shkencore, ne jemi duke punuar në mënyrë të palodhur për të prodhuar rezultate dhe për të dhënë rekomandime që mund të ndihmojnë shtetet e kërcënuara nga ethet afrikane të derrit, të mbrojnë kafshët dhe ekonominë e tyre.”

“Vitin e kaluar ne vendosëm të zbatonim njohuritë tona shkencore në terren dhe të tregonim se EFSA është e përkushtuar për të ndihmuar fermerët dhe personat e tjerë që ndikohen nga kjo sëmundje. Fushata u prit mirë në shtetet e para ku u aplikua dhe tani ne po shkojmë më tej me mesazhin tonë për të zbuluar, parandaluar dhe raportuar.”

Fushata mbështet përpjekjet e vazhdueshme të Komisionit Evropian dhe organizatave të tjera ndërkombëtare që synojnë asgjësimin e sëmundjes në Evropë

**Çfarë janë ethet afrikane të derrit?**

Ethet afrikane të derrit (ASF) është një sëmundje virale që prek derrat e butë dhe derrat e egër. Virus është i padëmshëm për njerëzit, por ka shkakton dëme të konsiderueshme ekonomike në shumë shtete. Nuk ka vaksinë, kështu që një përhapje e infektimit mund

dhe u drejtohet grupeve të njerëzve dhe individëve që janë në kontakt me derrat e butë dhe derrat e egër, veçanërisht fermerët që merren me rritjen e derrave. Ajo po zbatohet me ndihmën e paçmuar të organizatave veterinarë vendore, grupeve të fermerëve, shoqatave të gjuetisë, policisë kufitare dhe organeve të tjera përkatëse.

**Zbulo, parandalo, raport**

Duke qenë se përhapja e ASF-së mund të ketë pasojat



të kërkojë therjen e një numri të madh të derrave që rriten në fermat e zonave të prekura.

**Objektivat dhe audienca**

Fushata synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe njohjen e kësaj sëmundje në 18 shtete

shkatërruese: zbulimi, parandalimi dhe raportimi janë elementët thelbësor për të frenuar këtë sëmundje. Këto janë fjalët kyçe të fushatës.

Zbuloni më shumë në faqen e internetit të fushatës: <https://efsa.gitlab.io/multimedia/asf/index.html#/al/>

## Pijet alkoolike në Shqipëri kushtojnë më shtrenjtë se mesatarja europiane, sipas Eurostat

Pijet alkoolike në Shqipëri kushtojnë rreth 9% më shtrenjtë sesa mesatarja e Bashkimit Evropian për vitin 2020.

E dhëna është bërë e ditur nga Eurostat në publikimin e treguesit për indeksin e nivelit të çmimeve për pijet alkoolike, e llogaritur sipas nivelit të fuqisë blerëse. Për Shqipërinë, ky tregues është 108.9, ndërsa mesatarja e Bashkimit Europian është 100.

Çmimet e pijeve alkoolike në vend janë rritur ndjeshëm në dekadën e fundit, teksa në 2011-n, ato ishin rreth 23.5% më të lira sesa mesatarja e BE-së.

Pijet alkoolike më të shtrenjtat në rajon për vitin 2020 janë në Bosnjë (144.9), Mal të Zi (111.5) dhe pastaj në Shqipëri. Më lirë ato kushtojnë në Maqedoninë e Veriut (76.2) dhe Serbi (81). Për Kosovën, të dhënat e fundit janë në vitin 2017, sipas të cilës pijet alkoolike kushtojnë sa mesatarja e Bashkimit Europian.



shtrenjtë në krahasim me atë më të lirë.

Kur nivelet e çmimeve krahasohen me indeksin mesatar të nivelit të çmimeve të BE-së 100, rezultatet tregojnë se

çmimi i pijeve alkoolike (pije alkoolike, verë dhe birra) ishte më i larti në Finlandë (me një indeks të nivelit të çmimeve prej 193), i ndjekur

nga Irlanda (181) dhe Suedia (166).

Pijet alkoolike më të lirë në Europë i gjeni në Maqedoninë e Veriut (76.2), Rumani (73.8) dhe Hungari (72.7).



## OPINION

(Vijon nga gazeta paraardhëse)

**3. Niveli i ulët e i papërfillshëm i mbështetjes nga Shteti, problemi kyç për përmirësimin e gjëndjes së bujqësisë dhe fshatit.**

Mendoj se sekret i suksesit për organizimin e kooperimit në bujqësi dhe kryerjen e investimeve themelore, qëndron në faktin se sa Shteti është i impenjuar për gjetjen dhe përdorimin e levave ekonomike,

miliarda dollarë nga donacionet dhe projektet e BE-së, USAID-it, FAO-s, nga marrëveshjet bilaterale të shumë shteteve si Italia, Gjermania, Holanda, Japonia, etj., pa përmendur



**Shkëlqim Agolli, Ekonomist Agrar**

për zbulimin e burimeve financiare për rritjen e mbështetjes së bujqësisë dhe të fshatit. Justifikimi, që përdoret rëndom, për mundësitë e kufizuara të Shtetit, për akordimin e më shumë fondeve, nuk është i saktë. Fondet nuk kanë munguar as në këto 30 vjet. Janë akorduar dhe shpenzuar disa

huatë dhe kreditë me interesa të ujëta dhe me afate të gjata shlyerje të Bankës Botërore, FMN-së dhe institucioneve të tjera financiare ndërkombëtare. Me të drejtë shtrohet pyetja: Po çfarë është bërë me këto fonde të konsiderueshme për bujqësinë? Shumë pak për të mos thënë asgjë dhe, sic thotë

populli, ato humbën si “urina e pulës”. Ka shëmbuj të shumtë për impaktin dhe efektivitetin tepër të ulët të tyre. Vetëm nga Banka Botërore u dhanë për rehabilitimin e sistemit ujëtar mbi 300 milionë dollarë investime, por uji nuk arriti kurrë në ara dhe sipërfaqja e ujitur nuk u rrit aspak.

Gjithashtu, niveli shumë i ulët i mbështetjes së bujqësisë nga Buxheti i Shtetit, gjatë këtyre 30 vjeteve, tregon për vlerësimin e pamjaftueshëm dhe qëndrimin indiferent të qeverisjeve të ardhura në pushtet. Gjatë kësaj periudhe të gjatë kohore, bujqësisë i janë dhënë çdo vit vetëm 0.5 deri 2% nga Buxheti i Shtetit, nga rreth 22% që është kontributi i saj në Prodhimin e Përgjithshëm Bruto të vëndit. Një qëndrim i tillë është krejt i padrejtë. Argumenti se, kaq janë mundësitë e “Shtetit tonë të vogël”, është justifikim. Për mendimin tim çështja qëndron në mos vendosjen e raporteve të drejta e të studiara, midis investimeve prodhuese me investimet joprodhuese. Ky raport është dukshëm në favor të investimeve joprodhuese dhe kjo është e gabuar. Është mirë të kemi 4 aeroporte, nga 1 që kemi patur deri tani, mirë

është që të gjitha qytetet të kishin stadione moderne, apo të kishim më shumë autostrada etj. Ato pa dyshim janë të nevojshme, por mund të bëhen gradualisht dhe të rriten investimet themelore në bujqësi. I njejtë opinion është edhe për ato qindra koncesionet dhe PPP-të të dhëna, kryesisht për shërbime dhe, pothuajse asnjë për investime prodhuese. Për këto Shteti paguan çdo vit disa dhjetra milionë euro. A nuk do të ishte më e dobishme dhënia me kocension apo me PPP, rehabilitimi i sistemit të ujitjes e kullimit të disa rajoneve të vëndit?

Menaxhimi racional i fondeve që vijnë nga jashtë vëndit, i fondeve nga Buxheti i Shtetit, si dhe i koncesioneve dhe PPP-ve, do të ishin një burim i mirë për të rritur mbështetjen financiare për bujqësinë. Nga rreth 20 milionë dollare, në rastin më të mirë, që i janë dhënë bujqësisë në vit nga Buxheti, mund dhe duhet ti jepen jo me pak se 300 milionë dollarë, ose aq sa i jep Shteti fqinj i Maqedonisë së Veriut, madje edhe Kosova. Pra, mundësitë për gjetjen e burimeve për rritjen e mbështetjes së bujqësisë janë, por për fat të keq ka munguar

vëmendja dhe vizioni i duhur i Qeverise dhe angazhimi Juaj personal, për ti realizuar ato. Kjo mund të arrihet lehtësisht vetëm nga shtyrja pak vite të ndërtimit të një stadiumi, ose të një aeroporti, apo të 20 km më pak autostrade. Kaq e thjeshtë është zgjidhja e këtij problem. Mos përpiqemi të gjejmë argumente për të kundërtën.

**Zoti Kryeministër,** si mund të krahasohet një “sakrificë” e tillë për të shtyrë në kohë ndonjë investim jo prodhues, për të rritur mbështetjen financiare për bujqësinë, që do të ndikonte ndieshëm në rritjen e prodhimit bujqësor dhe do të përmirësonte nivelin e jetesës në fshat? A e kuptoni këtë politikë të gabuar ekonomike, që ngarkon me përgjegjësi PS-në, Qeverinë dhe Ju personalisht?

Për ta mbyllur ceshtjen e rritjes se nivelit të mbështetjes së bujqësisë nga Shteti, dua të nenvizoj lidhjen që ky problem ka me kooperimin e bujqësisë. Efektiviteti i investimeve themelore do të rritej dukshëm nese fondet do tu jepeshin kooperativave me perparesi, duke i plotësuar seciles prej tyre 100% nevojat.

Në këtë mënyrë do t'i “dilet borxhit” edhe ekonomive bu-

jqësore familjare që nuk do të ishin organizuar në kooperativa bujqësore të bashkëpunimit.

Ndryshimi i qëndrimit të deri sotëm, ndaj kooperimit dhe investimeve themelore në bujqësi, do të jepte efekte positive të menjëhershme, sepse:

- Bujqësia do të hynte në rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm e të modernizimit, duke dalë nga ky tranzicioni mundimshëm.

- Do të ndikonte në rritjen e rendimenteve dhe prodhimeve bujqësore e blegtorale, për eksport dhe tregun e brendshëm, duke shtuar sipërfaqet e kultivuara dhe duke zbatuar teknologjitë bashkëkohore.

- Do të frenonte braktisjen e fshatrave dhe largimin për të punuar në bujqësi nëpër Evropë.

- Do të ndikonte në përmirësimin e nivelit të prekur të jetesës për gjysmën e popullsisë të vëndit që jeton e punon në fshat, nga rritja e të ardhurave dhe ulja e kosos shumë të lartë të prodhimit bujqësor.

- Do të mënjanonte abuzimet e sekserëve dhe tregëtareve të shumicës, të cilët në marrëveshje të pa ndershme midis tyre, ja xhvatën prodhimet fshatarëve me cmime shumë të ulëta dhe nën kosto.

- Do të rriteshin të ardhurat për buxhetin dhe do të zgjidhej përfundimisht problem i informalitetit në bujqësi.

*Me respekt  
Shkëlqim Agolli  
Ekonomist Agrar*

## Tregu i përbashkët rajonal - Anketa me 400 biznese: 73% e tyre raportojnë barrierat jo-tarifore si pengesa të mëdha

Një anketim i këtij viti në 400 biznese në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor i realizuar nga Forumi Rajonal i Dho-

Për funksionimin e Tregut Rajonal, kompanitë ngritën çështjen e standardeve unike si një nga çështjet më të rëndësishme për



mave të Tregtisë në WB6 CIF) gjeti se, 73% e kompanive të intervistuar përballesh me probleme tregtare lidhur me masat jo tarifore në tregtinë ndërrajonale. Barrierat kryesore jo-tarifore janë: Rregullat e origjinës, barrierat teknike për tregti, dhe masa që lidhen me eksportin. 76% e kompanive të intervistuar pohuan se përballesh me probleme në lidhje me administrimin dhe procedurat në dogana.

Shumica e tyre raportuan mungesë informacioni në dispozicion të publikut, probleme me formalitetet që lidhen me importin, eksportin dhe tranzitin, probleme që lidhen me zhdoganimin e mallrave dhe problemet me tarifatat dhe gjobat e vendosura në lidhje me tregtinë.

krijimin e një tregu rajonal.

Gjithashtu pengesa e dytë më e madhe shihet marrja së lejeve të punës për punonjës që kërkojnë të angazhohen në vende të tjera të Rajonit.

70% e kompanive të intervistuar janë të angazhuara në tregtinë e jashtme dhe rreth 5% e kompanive janë të interesuara për tregti, por raportojnë barrierat në tregti.

Në kuadër të nismës për krijimin e tregut Rajonal, dhomat e tregtisë, nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia, Bosnja dhe Serbia kanë formuar një forum të përbashkët për të paraqitur në mënyrë të njehsuar problematikën dhe kërkesat e biznesit në kuadër të këtij procesi.

Forum i përbashkët për-

faqëson rreth 350,000 kompani, kryesisht ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe ka për mision bashkëpunimin e komunitetit të biznesit brenda Rajonit për të lehtësuar pengesat e mbetura për zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik rajonal dhe përmirësimin e klimës së biznesit dhe investimeve në tregjet e rajonit të BB.

Bizneset në të gjithë rajonin përveç barrierave tregtare, kanë vlerësuar si problematike kohën e gjatë në proceset e përpunimit të mallrave në dogana. Koha e pritjes është vënë në monitorim nëpërmjet buletini të përditshëm për minutat që harxhon një kamion në doganat hyrëse.

Forum i Rajonal i dhomave të Tregtisë gjithashtu ofron asistencë dhe ndihmesë për kompanitë e Rajonit që duan të futen në tregjet e BE-së. Dy platforma online po zhvillohen për këtë qëllim. Njëra është “platforma e aksesit në tregje” e cila do të ketë të dhëna furnizuesit e dyta është “Platforma e inteligjencës së Tregut”.

Gjatë këtij viti më shumë se 2000 kompani në Rajon do të listohen si furnizues të mundshëm dhe përfshijnë sektorë që nga industria e lehtë, industria automobilistike, biznese që aplikojnë ekonominë qarkulluese dhe agro-ushqimi.

## Bie lehtë sipërfaqja e pyjeve në vend

Në vitin 2020, fondi pyjor dhe kullor i Shqipërisë shtrihet në një sipërfaqe të përgjith-

në rreth 54.845.573 (m<sup>3</sup>), nga të cilat 94,0 % e këtij vëllimi përbëhet nga pyjet publike dhe



shme prej 1.740.304 (ha), duke përfaqësuar 60,5 % të sipërfaqes gjithsej të vëndit, sipas të dhënave të INSTAT.

Në krahasim me vitin 2016, sipërfaqja pyjore ka rënë lehtë, me rreth 0.3%.

Në 2020, pyjet shtrihen në një sipërfaqe 1.051.841 (ha), që përfaqëson 60,4% të fondit pyjor dhe kullor.

Kullotat dhe livadhet zënë një sipërfaqe 478.081 (ha) ose 27,5% të fondit pyjor dhe kullor. Sipërfaqet me bimësi pyjore dhe jo-produktive të cilat janë pjesë e fondit pyjor zënë një sipërfaqe 210.382 (ha) ose 12,1% të këtij fondi.

Në sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullor në vitin 2020, si rezultat i dukurive natyrore dhe aktivitetëve njerëzore, ka një rënie me rreth 2,2 (ha), krahasuar me vitin 2019.

Në vitin 2020, vëllimi i përgjithshëm i pyjeve, arrin

6,0% nga pyjet private. Vëllimi i përgjithshëm i pyjeve është ulur afërsisht me 1.113 (m<sup>3</sup>), krahasuar me vitin 2019.

Në vitin 2020, në fondin pyjor sipërfaqen më të madhe e zënë fletorët me 49,8%, ndjekur nga të tjera lloje me 35,8% dhe halorët 14,3%.

dhe turistike në vëndin tonë, janë konsideruar si pjesë tokësore dhe ujore të mbrojtura për shkak të shumëllojshmërisë biologjike të pasurive natyrore dhe kulturore që ato ofrojnë.

Zonat e mbrojtura në vitin 2020 zënë një sipërfaqe të përgjithshme prej 523.831/ha, duke përfaqësuar 30,0% të sipërfaqes së fondit pyjor dhe rreth 18,0% të sipërfaqes së përgjithshme të vëndit. Në vitin 2020 nuk ka patur ndryshime në numrin dhe sipërfaqen e zonave të mbrojtura.

Në vitin 2020, sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e zënë parqet kombëtare me 44,0% të sipërfaqes gjithsej, ndjekur nga rezervat natyrore të menaxhuara me 32,3%, peizazhet e mbrojtura me 18,6%, zonat e mbrojtura të menaxhuara 3,5%, rezervatet natyrore 0,9% dhe monumentet

| Kategoria e zonës së mbrojtura            | Numri i zonave (Nr) |            |            |            |            | Sipërfaqja (Ha) |                |                |                |                |
|-------------------------------------------|---------------------|------------|------------|------------|------------|-----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
|                                           | 2016                | 2017       | 2018       | 2019       | 2020       | 2016            | 2017           | 2018           | 2019           | 2020           |
| Rezervë Strikte Natyrore                  | 2                   | 2          | 2          | 2          | 2          | 4.800           | 4.800          | 4.800          | 4.800          | 4.800          |
| Park Kombëtar                             | 15                  | 15         | 14         | 14         | 14         | 210.501         | 210.501        | 230.707        | 230.707        | 230.707        |
| Monument Natyror                          | 750                 | 750        | 750        | 725        | 725        | 3.470           | 3.470          | 3.470          | 3.470          | 3.470          |
| Rezervat Natyror i Menaxhuar              | 24                  | 24         | 25         | 25         | 25         | 144.685         | 144.685        | 169.275        | 169.275        | 169.275        |
| Peizazhi i Mbrojtur                       | 5                   | 5          | 6          | 6          | 6          | 95.864          | 95.864         | 97.333         | 97.333         | 97.333         |
| Zonë e Mbrojtur e Burimeve të Menaxhuara  | 4                   | 4          | 4          | 4          | 4          | 18.245          | 18.245         | 18.245         | 18.245         | 18.245         |
| <b>Gjithsej</b>                           | <b>800</b>          | <b>800</b> | <b>801</b> | <b>776</b> | <b>776</b> | <b>477.566</b>  | <b>477.566</b> | <b>523.831</b> | <b>523.831</b> | <b>523.831</b> |
| Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit |                     |            |            |            |            |                 |                |                |                |                |

**Zonat e mbrojtura**  
Zonat e mbrojtura natyrore

natyrore 0,7%.  
*Revista “Monitor”*





# TASE GROUP

Adresa: Rruga e Kavajës, Qendra Kondor (ish parku i autobuzave, poshtë "21 Dhjetorit"), Tiranë  
Tel: 0035542239968; Fax/Tel: 0035542220027; e-mail: [info@tasegroup.al](mailto:info@tasegroup.al);  
Website: [www.tasegroup.al](http://www.tasegroup.al); Celular: 0684855580 (Kushineta, Premistopa dhe rripa)  
Celular: 0672035581 (Pjesë këmbimi për traktorë)



## Ofrojmë:

- PJESE MOTORIKE
- FREKSIONE
- PERMISTOPA
- KUSHINETA
- RRIPI
- AKSE
- PJESE ELEKTRIKE
- PJESE HIDRAULIKE
- VAJRA DHE FILTRA



# KASH

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

[www.kashalbania.org](http://www.kashalbania.org)

## Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar







Deri në **4 500 000 LEKË**

## **KREDI PËR SERA PA KOLATERAL**



## **GJITHMONË FINANCË SOCIALE**

Rr. Qemal Stafa, Pall. 9 katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i Ri, Tiranë.  
+355 4 2251910/1 | [info@fedinvest.al](mailto:info@fedinvest.al) | [www.fedinvest.al](http://www.fedinvest.al)



Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO) ka hyrë në një epokë të re, me një strukturë dhe dinamikë të re. Axhenda 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) po afrohen dhe nevoja imediate

# FAO në prag të Samitit të Sistemeve Ushqimore të OKB, së bashku për transformimin e Sistemeve Agro-Ushqimore

*Op-Ed nga Drejtori i Përgjithshëm i FAO-s*



QU Dongyu  
Drejtori i Përgjithshëm  
Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë

për ndryshimin e sistemeve tona agro-ushqimore është urgjente dhe holistike. Ky transformim kërkon një qasje sistematike dhe aksion kolektiv – nisma Hand in Hand duke filluar nga prodhuesit, shpërndarësit dhe konsumatorët, së bashku me qeveritë, sektorin privat, akademinë dhe shoqërinë civile.

Ky është synimi i Samitit të ardhshëm i Kombeve të Bashkuara për Sistemet Ushqimore dhe atë që FAO dëshiron të arrijë, së bashku me të gjithë partnerët tanë, përmes Kornizës së re Strategjike të FAO 2022-2031. Veprimi i secilit prej nesh ka një ndikim në të ardhmen e planetit përmes përmirësimit të sistemeve tona agro-ushqimore.

Samiti është në kohë. Pas dekadesh rënie, vetëm gjatë pesë viteve të fundit numri i

njerëzve të uritur është në rritje, duke shkuar sot në 811 milionë njerëz. Në të njëjtën kohë, obeziteti dhe sëmundjet e tjera jo-ngjitëse përbëjnë probleme globale gjithnjë e në rritje, në lidhje me pamjaftueshmërinë në ushqim dhe modelin e duhur të dietave të shëndetshme. Shumë nga praktikatat aktuale agro-ushqimore po i shkaktojnë një dëm të madh planetit tonë. Sistemet tona agro-ushqimore nuk po funksionojnë ashtu siç duhet. Çfarë duhet të bëjmë për t'i transformuar ato? Si ndikon çdo individ në këtë proces?

FAO, si organizatë kryesore ndërkombëtare në këtë fushë, ka mbrojtur dhe mbështetur transformimin e sistemeve agro-ushqimore. “Sistemi agro-ushqimor” përfshin udhëtimin e ushqimit nga prodhimi në tryezë, nga

koha kur mbillet, rritet, korret, përpunohet, pakëtohet, transportohet, shpërndahet, tregtohet, blihet, përgatitet, konsumohet dhe asgjësohet. Ai përfshin edhe produkte jo ushqimore si pyjet, rritjen e kafshëve, përdorimin e lëndëve të para, biomasa për prodhimin e biokarburanteve dhe fibrave, përbën të gjitha aktivitetet, investimet dhe zgjedhjet e bëra, dhe ndikon në jetesën e të gjithë njerëzve që luajnë një rol në marrjen e produkteve agro-ushqimore.

FAO me ekspertizën e saj, duke filluar nga politika dhe fizibiliteti, inovacioni, kërkimi shkencor, përdorimi i tokës dhe ujit, blegtoia dhe peshkimi, deri te biodiversiteti dhe klima, siguria e ushqimit, puna normative, të dhënat gjeohapësinore dhe teknologjia dixhitale, ka qenë në pararojë duke mbështetur përgatitjen e këtij Samiti të rëndësishëm global dhe më e rëndësishmja, në përputhje me mandatin e saj FAO pritet të marrë drejtimin për të zbatuar veprimet pasuese pas Samitit.

Në korrik, Para-Samiti i Kombeve të Bashkuara për Sistemet Ushqimore arriti një sukses të jashtëzakonshëm, i cili u organizua në selinë e FAO-s në Romë. Së bashku me Drejtuesin Ekonomik dhe Drejtuesin e Kërkimeve Shkencore në FAO, kam qenë pranë organeve këshilluese të Samitit,

grupeve shkencore dhe pistave të veprimit. Kemi punuar ngushtë me kolegë ekspertë brenda dhe jashtë sistemit të OKB-së. Me praninë e mbi 130 vende, ekipet tona në terren kanë mbështetur “dialogjet kombëtare” që kontribuojnë në rezultatet e samitit dhe përparësitë kombëtare duke siguruar synimin dhe orientimin drejt zgjidhjes.

Transformimi i sistemeve tona globale të agro-ushqimit qëndron përfundimisht me aksionet në vend dhe në nivel lokal. Kultura është një aspekt i rëndësishëm. Duhet vetëm të shikosh kuzhinat për të parë se sa të larmishme janë sistemet agro-ushqimore brenda vendeve. Më shumë se gjysma prej nesh (rreth 4.5 miliardë njerëz) fitojmë jetesën drejtpërdrejt përmes zinxhirit të prodhimit agro-ushqimor, zinxhirit të furnizimit dhe zinxhirit të vlerës dhe ne të gjithë jemi konsumatorë të ushqimeve dhe ndryshues të rregullave të lojës.

Çfarë duhet për të transformuar? Ne në FAO kemi identifikuar katër akselatorë ndërsektorialë/sectorialë: teknologji, inovacion, të dhëna dhe “komponente plotësuese” (qeverisja, kapitali njerëzor dhe institucionet). FAO është duke u organizuar dhe duke u përgatitur më mirë gjatë dy viteve të fundit për të udhëhequr pro-

cesin. Korniza jonë e re Strategjike e miratuar nga Anëtarët fokusohet në mbështetjen e arritjes së SDG-ve përmes transformimit të sistemeve agro-ushqimore me SHUMË efikasë, gjithëpërfshirëse, elastike dhe të qëndrueshme për arritjen e “Katër të mirave”: prodhim më i mirë, ushqim më i mirë, një mjedis më i mirë dhe një jetë më e mirë.

Ne kemi reformuar strukturën tonë organizative dhe kemi bërë atë më modulare dhe të shpejtë në mënyrë që të bëhemi të përshtatshëm për arritjen e qëllimit. Për shembull, pozicioni i sapokrijuar i Drejtuesit të Kërkimit Shkencor, së bashku me një Zyrë për Inovacionin dhe Zyra e SDG-ve janë hapa konkretë për të forcuar rolin e shkencës dhe inovacionit për të plotësuar punën socio-ekonomike të udhëhequr nga Drejtuesi Ekonomik në mbështetje të transformimit, si dhe arritjes së SDG -ve. Inovacioni nuk ka të bëjë vetëm me teknologjinë. Ka të bëjë edhe me qasjet dhe politikat. Bëhet fjalë për mentalitetin.

Vendet, komunitetet dhe industritë do të përcaktojnë rrugët e tyre transformuese. Qëllimi ynë është pragmatik: vendosja e pronësisë së anëtarëve dhe mbështetja e tyre, duke ecur në bisedime dhe arritur rezultate konkrete në terren.

FAO ka ekspertizën dhe rrjetet dhe një grup të madh mjetesh për të ndihmuar. Nisma jonë Hand-in-Hand ka krijuar platforma gjeohapësinore me qasje të hapur të cilat përfshijnë menaxhimin e pyjeve, integrimin e sekuesttrimit të karbonit dhe nivelin e avullimit të ujit. Sistemet dhe rrjetet tona të paralajmërimit të herës mund të paralajmërojnë për thatësira të ardhshme ose dëmtues të bimëve. Aplikimet tona llogarisin kushtet e ofertës dhe kërkesës për foragjere në zonat e prirura ndaj thatësirës ose konfliktit. Për më tepër, puna jonë analitike, duke përfshirë punën tonë të re në modelim, vlerësoi kohët e fundit ndikimet dhe kompromiset e veprimeve dhe sistemeve të propozuara të cilat shpesh kanë efekte të dëmshme sociale, ekonomike dhe mjedisore, si dhe përcaktimin e shfrytëzimit sa më mirë të mbështetjes fiskale për sistemet agro-ushqimore.

FAO është e mirëvendosur dhe e gatshme të marrë përgjegjësinë e plotë pas rezultateve të Samitit dhe të ecë përpara për të katalizuar ndikimet së bashku me të gjithë aktorët dhe miqtë.

Sistemet agro-ushqimore janë komplekse dhe të ndryshme. Të gjithë jemi dakord se ata nuk e arrijnë potencialin e tyre nëse vazhdojnë të funksionojnë si zakonisht. Ne duhet të gjejmë zgjidhje për të arritur “Katër të mirat” dhe të mos lëmë askënd prapa. FAO ka kapacitetin për të udhëhequr këtë proces me partnerët për një botë më të mirë.

## Plani i veprimit kombëtar, një udhërrëfyes për avancimin e bujqësisë familjare në Shqipëri

Procesi për zhvillimin e planeve kombëtare të veprimit për bujqësinë familjare në vendet e zgjedhura në Evropë dhe Azinë Qendrore ka filluar me mbështetjen e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO). Planet e veprimit do të sigurojnë një kornizë specifike në Shqipëri, Kirgistan dhe Republikën e Moldavisë, duke promovuar bashkëpunimin ndërinstitucional me synim avancimin e mirëqenies së fermerëve familjarë dhe t'i ndihmojë ato të bëhen aktorë për transformimin ekonomik, mjedisor dhe social, siç është parashikuar nga Dekada e Kombeve të Bashkuara për Bujqësinë Familjare (UNDRF) 2019–2028.

Planet e veprimit do të trajtojnë bujqësinë familjare nga një perspektivë holistike duke mbështetur integrimin e çështjeve lidhur me bujqësinë familjare në politikat dhe strategjitë kombëtare për ushqimin dhe sektorët më të gjerë bujqësorë, socialë dhe mjedisorë, ekonomikë dhe të zhvillimit rural.

Në të tre vendet, një plan veprimi do të zhvillohet përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke filluar me një dialog pjesëmarrës dhe i ndjekur nga një seri konsultimesh kombëtare dhe rajonale me fermerët dhe organizatat e fermer-

ëve, qeverinë dhe të tjerët, së bashku me rishikimin e legjislacionit përkatës kombëtar dhe ngritjen e kapaciteteve të partnerëve lokalë. Përfundimisht, projekt-plani i veprimit do të

të dëgjohen të gjithë zërat për planet e veprimit kombëtar, duke e bërë atë një mjet të fuqishëm për transformimin e qëndrueshëm të sistemeve ushqimore dhe zonave rurale,” tha

të prekshme.”

Planet e veprimit, përfshirë rekomandimet specifike për të mbështetur zbatimin e tyre, pritet të jenë gati deri në fund të vitit 2022 dhe do të shtjelo-



Foto: ©FAO/Dorin Goian

diskutohet dhe vërtetohet nga partnerët përkatës para se të finalizohet.

“Fermat familjare janë të shumëllojshme dhe kjo qasje e plotë duhet të sigurojë që të gjitha çështjet të adresohen dhe

Viktorya Ayvazyan, specialiste e FAO-s për zhvillimin rural. “Dekada e Kombeve të Bashkuara për Bujqësinë Familjare është një mundësi e madhe, por kërkon nga ne që ta kthejmë atë në veprim dhe në rezultate

lojnë tema të tilla si rinia rurale dhe qëndrueshmëria e brezave në bujqësinë familjare, barazia gjinore, qasja, menaxhimi dhe përdorimi i tokës dhe burimeve të tjera natyrore, përfshirjen socio-ekonomike dhe elastic-

itetin e fermerëve familjarë, familjeve rurale dhe komuniteteve. Ata gjithashtu duhet të sigurojnë që bujqësia familjare dhe përparimi i zonave rurale të lidhet dhe të kontribuojë në zbatimin e Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG).

“Fermerët familjarë kanë një kontribut shumëdimensional në zhvillimin e qëndrueshëm prandaj, një kornizë gjithëpërfshirëse dhe koherente e politikave që u mundëson atyre të realizojnë këtë potencial në mbështetje të drejtpërdrejtë të arritjes së Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm,” shoi Ayvazyan.

Vendi i parë që nisi procesin në gusht ishte Kirgistani, në bashkëpunim me Unionin Kombëtar të Shoqatave të Përdoruesve të Ujit dhe Forumin Botëror Rural. Shqipëria dhe Republika e Moldavisë pritet të vijojnë së shpejti.

Zhvillimi i planeve kombëtare të veprimit për bujqësinë familjare parashikohet nga një Plan Veprimi Global në zbatim të UNDRF, i zhvilluar në vitin 2019, nga Sekretariati i Dekadës dhe i krijuar së bashku nga FAO dhe Fondi Ndërkombëtar

bëtar për Zhvillimin Bujqësor (IFAD). Qëllimi është që të ketë 100 plane kombëtare të veprimit në fuqi globalisht deri në vitin 2024.

### Rreth Dekadës së Kombeve të Bashkuara për Bujqësinë Familjare

Në Dhjetor 2017, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara shpalli Dekadën e Kombeve të Bashkuara për Bujqësinë Familjare 2019–2028 për të inkurajuar të gjitha shtetet që të zhvillojnë, përmirësojnë dhe zbatojnë politikat publike për zhvillimin e bujqësisë familjare dhe të ndajnë përvojat e tyre dhe praktikatat më të mira të bujqësisë familjare me të tjerët. Rezoluta u bën thirrje qeverive, organizatave ndërkombëtare, shoqërisë civile, sektorit privat dhe qarqeve shkencore, të kontribuojnë në mënyrë aktive në zbatimin e Dekadës.

Dekada do të vendosë gra, burra fermerë dhe të rinj rurale në qendër të strategjisë dhe planit të saj të veprimit. Kjo do të thotë se ata do të jenë agjentë të zhvillimit të tyre, duke kontribuar në politikat publike, ndërsa njohuritë dhe jetesa në komunitet do të njihen si çelësi i zhvillimit bujqësor.

*Procesi ndërkombëtar mbështetet nga FAO dhe IFAD.*



## KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

## MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

## DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

## QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE KORÇË

KËSHILLA PËR FERMERËT PËR PERIUDHËN  
SHTATOR 2021

Për t'i ardhur në ndihmë fermerëve, që të jenë të kujdesshëm, në vjelje, ambalazhim, transport dhe ruajtje të frutave, me qëllim që t'i japin konsumatorit produkte cilësore për konsum për një kohë sa më të gjatë, po trajtojmë disa nga praktikën e përshtatshme të vjeljes së frutave (mollës). Procesi i ruajtjes, përpunimit dhe menaxhimit të prodhimit fillon që me përcaktimin e momentit të vjeljes. Konkretisht për vjeljen e frutave në përgjithësi e sidomos për mollën në veçanti duhet të mbajmë parasysh disa specifika.

- Vjelja duhet të bëhet në pjekjen teknike (kur frutat kanë arritur përmbajtjen e nevojshme të sheqernave, aminoacideve dhe përbërësve të tjerë në raporte të drejta), të pëlqyeshme për konsum.

- Gjithashtu në kohën para vjeljes kur frutat kanë filluar të marrin ngjyrën specifike të kultivarit mund të kryejmë një trajtim kundër kalbëzimit të frutave dhe rezistencës në ruajtje me preparatin "Zato". me dozën 0.0-0.015 %.

**Vjelja e prodhimit dhe rëndësia e tij**

Koha e vjeljes së frutave luan një rol të madh dhe të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe sasinë e frutave, aftësinë e tyre për t'i qëndruar transportit dhe ruajtjes nëpër magazina e frigoriferë. Frutat e vjela parakohe nuk kanë shijen dhe pamjen karakteristike të tyre dhe nuk rezistojnë në ruajtje, ndërsa frutat e vjela me vonesë janë të paqëndrueshme në transport dhe në ruajtje.

Në bazë të qëllimit që në kemi, bëjmë edhe vjeljen e prodhimit. Nqs ne duam që prodhimin ta tregtojmë direkt tek konsumatori, vjelja e tij do të bëhet në atë moment kur fruti ka marrë cilësinë e

shijes dhe vlerat ushqyese tipike për kultivarin, ndërsa kur ne duam që prodhimin ta ruajmë për një kohë të caktuar, vjelja e tij do të bëhet kur produkti nuk ka fituar ende shijen e plotë, karakteristike të llojit.

Ka një sërë treguesish ku ne duhet të mbështetemi për përcaktimin më me saktësi të vjeljes së kultivarit të mollës dhe dardhës në kohën e duhur si:

- Marrja e ngjyrës tipike për kultivarin e dhënë  
- Shkëputja e lehtë e bishtit të frutit nga degëzat frutore

- Errësimi dhe marrja e ngjyrës kafe të majave të farave.

- Shija karakteristike e frutit gjatë ngrënies etj.  
Fillimi i vjeljes është i varur nga destinacioni, ku llogaritet transporti për në ambientin ruajtës.

Mënyra e vjeljes ka të bëjë me disa momente të cilat duhet të respektohen dhe të zbatohen me korrektësi nga vjelësit apo punëtorët e zakonshëm, të cilët duhet të jenë të kujdesshëm, por gjithmonë nën kujdesin e punëtorëve më me përvojë. Gjatë vjeljes së frutave duhet të kemi parasysh disa kërkesa:

-Vjelja me bisht e frutave, me qëllim që fruti të mos humbasë lagështinë dhe të vyshket gjatë ruajtjes në magazinë.

- Ruajtja nga dëmtimi i cipës dhe i tulit. Gjatë vjeljes frutat që u dëmtohet cipa dhe tuli fillojnë të kalben menjëherë, për këtë punëtorët duhet të mos i përplasnin frutat nëpër arka, dhe t'i vjelin ato një nga një.

- Ruajtja e degëzave frutore gjatë vjeljes,

pasi nga moskujdesi i treguar nga punëtori do të kemi dëmtimin e sythave frutore për vitin e ardhshëm. Gjatë vjeljes përdoren arka ose kosha sipas mundësisë. Për pemët e larta duhet të përdorim patjetër shkallë me qëllim realizimin me sukses të këtij procesi.

Vjelja bëhet gjithmonë veçmas për çdo kultivar. Sa më shpejt të transportohen frutat, aq më të pakta do të jenë firot dhe aq më shumë do t'i qëndrojnë transportit për në destinacion e ruajtjes. Frutat mbahen në magazina të ajrosura, e më lagështi të caktuar, ndërsa në frigorifer ato ruhen në temperaturën 1-2 gradë C dhe në lagështi 90-95 %.

**Vjelja e prodhimit dhe parandalimi i humbjeve gjatë vjeljes**

Në kushtet e intensifikimit të prodhimit të frutave e me rritjen e kërkesave të konsumatorëve për të patur në treg fruta me një cilësi sa më të mirë (sipas standarteve), procesi i vjeljes së frutave merr një rëndësi të dorës së parë. Marrja e prodhimit në pemëtari me sa më pak firo është qëllimi kryesor i punës gjithëvjetoje të fermerëve. Vjelja është një proces teknik dhe organizativ, prandaj merren masa që më parë për përcaktimin e prodhimit të pritshëm dhe bëhen llogaritjet për fuqinë punëtore, ambalazhimin, materialet dhe mjetet e transportit, vendi ku do të transportohet prodhimi, ambientet apo magazinat e ruajtjes, frigoriferëve lokalë etj. Për të gjykuar mbi prodhimin e pritshëm për çdo

kultivar, në fillim të verës zgjidhen disa bimë me përfaqësues në pika të ndryshme të pemtores, mbi të cilat gjykojmë prodhimin mesatar që mund të japë secila bimë. Duke bërë edhe vlerësimin e përgjithshëm të gjendjes së pemtores, si dhe humbjet që mund të kemi nga sëmundjet dhe dëmtuesit, llogaritet edhe prodhimi i pritshëm. Duke kryer këto vrojtime jemi shumë afër realitetit për të marrë masat e nevojshme tekniko-organizative për vjeljen në kohë, e trajtimin si duhet të prodhimit të frutave. Për të kurorëzuar me sukses procesin e vjeljes së frutave duhet të përcaktojmë drejt kohën më të përshtatshme për vjeljen e tyre dhe mbas saj na mbetet detyrë:

- Ulja e firove.

- Marrja e prodhimit maksimal e me cilësi të lartë për transport dhe ruajtja sa më gjatë në magazinë apo frigorifer.

- Rritja e rendimentit në punë.

- Ruajtja e kurorave të pemëve nga dëmtimet gjatë procesit të vjeljes.

**Seleksionimi dhe ambalazhimi i prodhimit**

Seleksionimi i frutave mund të bëhet direkt, me vjeljen e prodhimit nga pema. Kjo është mënyra direkte, redukon koston, ul ndjeshëm humbjet që vijnë nga dëmtimet mekanike, duke krijuar kushte për një kohëzgjatje në ruajtje, pasi produkti kalon menjëherë në ambientin e ruajtjes. Seleksionimi i frutave brenda ambienteve frigoriferike kërkon dyfish kohë dhe një kosto më të lartë, pasi çdo arkë do të seleksionohet kokërr më kokërr.

Ambalazhimi duhet të jetë i tillë që të parandalojë dëmtimet fizike të frutave dhe të lehtësojë trajtimet dhe ruajtjen e tij për një kohë sa më të gjatë.

**Drejtorja e Teknologjive Bujqësore: QTTB-Korçë:**

**Sektori i Pemëve Frutore-farore E-mail:qttbkorce@yahoo.com**

## QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE KORÇË

KËSHILLA PËR FERMERËT QË MBARESHTOJNË  
BAGËTI TË IMTA (FERMAT E DHIVE)

Jemi në periudhën para fillimit të dimërimit të tufave të fermave tuaja (në fermat që nuk zbatojnë shtegëtimin e kafshëve).

Vëmendja dhe angazhimi juaj duhet të përqëndrohet në këto drejtime:

• Sigurimi i kushteve të strehimit sipas zonave ku mbarështoni tufën tuaj.

• Bilanci i të ushqyerit të tufave gjatë dimërimit sipas normave të të ushqyerit të kafshëve sipas një akt-dimërimi të hartuar nga specialist zooteknik.

• Përcaktimi hallkat për sigurimin e kushteve higjieno - sanitare dhe bëni zbatimin e tyre.

• Zbatimi planin e masave profilaktiko - veterinare si dehelmetizimet kundër parazitëve të brendshëm dhe të jashtëm, vaksinim kundër Paratifos, Agalaksisë, Enterotoksemisë etj. (këshillohuni me specialistin veterinar).

• Riparoni stallat dhe sigurohuni që baza ushqimore e depozituar të ruhet

mirë dhe të mos dëmtohet.

• Bëni analizë të rezultatit ekonomiko-financiar për vitin 2020-2021 dhe përcaktoni numrin e krerëve që do të mbarështoni gjatë periudhës së dimrit mbështetur në ushqimet e depozituara (bar i thatë, koncentratë, silazh etj.) dhe ushqimet e njoma si hasëllet, kullotat dimërore etj.

• Hartoni project-planin ekonomik të fermës për vitin pasardhës duke përcaktuar planin e prodhimeve, planin financiar ku përfshihen tregjet e shitjes të ardhurat dhe shpenzimet.

• Ju kujtojmë se veprimet tuaja teknike, ekonomike dhe financiare duhet të përditë-

sohen në dokumentacion që mbani për fermën tuaj.

**Për fermat e dhive**

Ju kujtojmë hallkat tekniko organizative për ndërzimin e dhive.

Periodha shtator-tetor është periodha e ndërzimit të dhive në të gjitha zonat (ndërzimi tradicional).

Ndërzimi i dhive realizohet me sukses nëse zbatohen këto hallka tekniko-organizative:

- Vazhdoni trajtimin e cjepëve dhe të dhive edhe gjatë fushatës sipas këshillave të specialistit zooteknik dhe atij veterinar.

- Dy javë para fillimit të fushatës dhe gjatë ndërzimit të mos bëhet asnjë lloj trajtimi veterinar etj.

- Kontrolli i dhive për afsh të bëhet me cjepët e kontrollit (të vazoeptomizuar ose me përparse) dy herë në ditë dhe gjithashtu edhe ndërzimi natyral të kryhet dy herë në ditë dhe i kontrollolluar.

- Të mos ndërrohet vendstrehimi i tufës së dhive (stalla, vatha) dhe të mos hiqet plehu para dhe gjatë fushatës së ndërzimit.

- Të zbatohet skema e çiftëzimit me këto kritere (të evitohet ndërzimi babë bijë, bir nënë, motër vëlla etj, eliminimi i bashkëgjakësisë). Për çdo cjaq të planifikohen për ndërzim 15-20 krerë dhi (minimalja për cjepët e rinj dhe maksimalja për cjepët e rritur). Për zbulim afshi të përdoret një cjaq për 50 krerë dhi.

- Të mbahen shënime përkatëse për afatet e fillimit të ndërzimit, koha e ndërzimit cjaqi ndërzyes, kthimet etj.

**Drejtorja e Teknologjive Blegtorale: QTTB- Korçë:**

**E-mail:qttbkorce@yahoo.com**



KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

(Vijon nga numri i kaluar)

TË USHQYERIT E KAFSHËVE TË FERMËS

Ushqimi i Sfidës (pak pas pjelljes, pas pjelljes)

Ushqimi i duhur para-pjelljes lejon që fermeri i aftë të sjellë shpejt lopët e tij në ushqim të plotë pas pjelljes. Gjatë ditëve të para pas pjelljes, koncentratit nuk duhet të rritet përtej sasisë së ofruar në para-pjelljes. Është më mirë të sigurohet foragjere cilësore, duke përfshirë sa më shumë sanë të thatë. Shërbeni disa kova me ujë të ngrohtë për të zvogëluar stresin e pjelljes. Ju duhet të siguroheni që lopa të konsumojë aq sa dëshiron dhe që jashtëqitja e sajë të mbetet e plotë për të parandaluar shtrembërimin e stomakut dhe ethet vitulare. Rreth 3 ose 4 ditë pas pjelljes, përdorni racionin e sfidës për të marrë prodhimin më të mirë të mundshëm, duke filluar me rritjen e sasisë së koncentratit. Shtoni një ushqim të pasur me proteina në koncentrat e cila është ushqimi kryesor me energji në fillimin e laktacionit. Ofroni suplementin e proteinave që nga ditët e para të laktacionit nëse nuk është shërbyer para barsmërisë. Proteinat stimulojnë oreksin dhe tretjen në lopë, e cila rifillon prodhimin. Kërkesat për proteina janë të larta në fillimin e laktacionit, duke arritur në 19% të L.Th. të racionit (Tabela 6). Në kulmin e prodhimit të qumështit, nevoja për proteina është 18%. Qëllimi është që të merrni lopët në maksimumin e ushqimeve të pasura me proteina në dy javët e para të laktacionit (Figura 1). Rritni gradualisht sasinë e koncentratit. Shumë i shtyrë, lopët do të vijnë për të treguar refuzim. Shumica e lopëve tolerojnë një rritje prej 1 kg çdo ditë tjetër në javën e parë, pastaj 0.5 kg çdo ditë tjetër në javën e dytë, dhe pastaj 0.3 kg çdo ditë të tjera në javën e tretë. Nëse nivelet e racionit para-pjelljes ishin të sakta, lopët do të sillen në konsumin e tyre maksimal të drithërave dhe proteinave brenda 3 - 3½ javëve të para

Figura. 1 ilustron se si të përdorim koncentratin dhe shtojcën e proteinave në racionet e barsmërisë dhe laktacionit të hershëm. Në këtë shembull, marrja e shtojcës së proteinave arrin kulmin e saj (4.5 kg ose 10 lb) në ditën e dhjetë të laktacionit, ndërsa ajo e koncentratit arrin kulmin e saj (10.5 kg ose 23 lb) në ditën e njëzet e dytë. laktacionit. Figura 1. Shtimi i koncentratit dhe proteinave në racionin e laktacionit para-laktacionit dhe laktacionit të hershëm (600 kg lopë, kulmi i laktacionit me 45 kg / d).

Tabela 3 tregon sasi të sugjeruara të

koncentratit për nivele të ndryshme të prodhimit. Këto sasi të koncentratit janë të përshtatshme për lopët në gjysmën e dytë të laktacionit të tyre, të cilët konsumojnë foragjere me cilësi të mesme dhe gjendja e trupit të të cilave është e qëndrueshme. Sasi të koncentratit në Tabelën 3 janë sasi të totale të koncentratit bazë (misri, elbi) ose përzierja e koncentreve, dhe proteina shtesë.

Sasi të drithit duhet të korrigjohen në situatat vijuese:

1) Tabela 3 bazohet në foragjere të cilësisë mesatare. Kur racioni ushqimor përbëhet kryesisht nga silazh misri me cilësi të shkëlqyeshme ose sanë, zvogëloni sasinë e drithërave me 10%. Nëse foragjere është me cilësi të dobët, shtoni 10% koncentrat

2) Mos shërbeni më shumë koncentrat se secila lopë mund të hahet me siguri. Maksimumi ditor për lopë është 2 deri në 2.5% të peshës së gjallë. Prandaj, një lopë me peshë 650 kg do t'i jepet jo më shumë se 13 - 16 kg.

3) Sasi të tabelën 3 vlejnë për koncentrat të thatë. Rritni sasi të nga 5 deri në 10% nëse koncentratit është e lagur.

4) Kompensoni përzierjen e zvogëluar të lopëve në fillimin e laktacionit me një rritje të përmbajtjes së drithërave. Lopët që kanë më pak se 100 ditë laktacion, ushqehen përveç përzierjes së koncentratit, siguron 1 deri 1.5 kg (2 deri në 3 lb) të proteinës shtesë për 5 kg (11 lb) qumësht mbi 35 kg (75 lb).

Shembuj: • Prodhimi prej 40 kg; duhen 40 / 2.5 kg koncentrat = 16 kg Prodhimi prej 5 kg mbi 35; Prandaj, nevoja për 1 ose 1.5 kg shtojcë proteine Shërbyer: 15 kg koncentrat + 1 kg shtesë proteine ose 14,5 kg koncentrat + 1,5 kg shtesë proteine • Prodhim prej 45 kg; duhet 45 / 2.5 kg koncentrat = 18 kg Prodhimi i 10 kg mbi 35; kështu që nevoja për 2 ose 3 kg shtesë proteine Shërbyer: 16 kg koncentrat + 2 kg shtesë proteine ose 15 kg kokërr + 3 kg suplement proteine

5) Të kënaqë nevojat e rritjes së mëshqerinjve duke u dhënë atyre në laktacionin e parë 1 deri 1.5 kg (2 deri 3 lb) shtesë, dhe ato në laktacionin e dytë 0,5 deri në 1 kg (1 deri në 2 lb), përveç nevojave në lidhje me prodhimin e qumështit.

6) Korrigjoni sipas energjisë së nevojshme për prodhimin e yndyrës së qumështit duke i dhënë 10% më shumë ose më pak koncentrat me 0.5% rritje ose ulje të përmbajtjes së yndyrës në krahasim me 4.0% .

7) Korrigjoni marrjen e drithërave sipas nevo-

jave të gjëndjes trupore pas pikut të prodhimit. Shtoni ose hiqni 2 deri në 3 kg (4 deri në 6 lb) për lopë të dukshme të ligët ose të yndyrshëm.

